

V E N D I M
Nr.482, datë 26.3.2001

**PËR MOSMIRATIMIN E MOCIONIT PËR DEBAT ME OBJEKT PROPOZIMIN PËR
SHKARKIMIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Kushtetuese e Ligjore dhe të Komisionit të Mandateve, Imunitetit e të Rregullores ,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Nuk miratohet mocioni për debat me objekt propozimin për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KUVENDI I SHQIPËRISË

DEKLARATË

datë 9.III.2001

Kuvendi i Shqipërisë vëren me shqetësim se qendrave të tensionit si Mitrovica e Lugina e Preshevës iu shtua së fundi edhe konflikti në fshatin Tanushevc të Maqedonisë. Kuvendi i Shqipërisë konfirmon edhe njëherë se është me vendosmëri kundër dhunës dhe ekstremizmave të çdo lloji. Çështjet që përbëjnë shqetësim mund të duhet të zgjidhen kurdoherë vetëm nëpërmjet bisedimeve.

Kuvendi ynë distancohet nga veprimet e dhunës të ndonjë grupi të shfaqur në Maqedoni nën etiketimet kombëtare. Ne kemi përkrahur e përkrahim mbarëvajtjen dhe stabilitetin në Maqedoni si një nga pikat kyçe të stabilitetit në rajon.

Ne ftojmë autoritetet maqedonase të tregojnë vetëpërmbytje lidhur me ngjarjet e fundit. Në tërësinë e këtyre ngjarjeve, të identifikohet përkatësia e personave që kryejnë akte terroriste, pa kaluar nga një incident i izoluar në një krizë të përgjithshme, sidomos të mos ndodhin shpërngulje të popullsisë. Problemet e brendshme të Maqedonisë nuk janë probleme të Kosovës. Bllokimi i kufirit me të, qoftë edhe i përkohshëm dhe kërkesa për një zonë tamponi në këtë kufi, janë të paarsyeshme. Shqiptarët që banojnë në të dy anët e kufirit kanë lidhje të përhershme dhe qarkullimi ndërmjet tyre s'mund të pengohet. Kurse marrëveshja e nënshkruar në Shkup nga Presidenti i Maqedonisë dhe z. Koshtunica mbi vijën e kufirit të dy vendeve është e pazbatueshme.

Ne shfaqim bindjen se zgjerimi i bashkëqeverisjes, i problemit të dy gjuhësisë e të tjera, që bëhen burim tensionesh, do të çohen përpara me durim e dialog paqësor, duke forcuar gjithnjë më tej stabilitetin e shtetit maqedonas.

Kuvendi vëren me shqetësim prirjen e kryetarëve të disa shteteve për të zmadhuar jashtë mase incidentet e fundit në Maqedoni, duke i ofruar asaj deri edhe ndihma ustharake. Sovraniteti i ish-R.J. të Maqedonisë nuk është nën kërcënim dhe akuza që iu bëhet në këtë drejtim shqiptarëve është krejt e pabazuar. Ndërrhyrjet e njëanshme të këtyre shteteve në çështjet e Maqedonisë e të Kosovës janë negative e duhet të marrin fund.

Kuvendi pohon se UNMIK-u dhe KFOR-i kanë qenë dhe janë faktor i pazëvendësueshëm i ruajtjes së paqes në rajon. Nën kujdesin e këtyre strukturave Kosova po shkon paqësisht drejt zgjedhjeve të përgjithshme dhe referendumit që do të përcaktojë të ardhmen e saj.

Ngjarjet në Kosovë e rreth saj dhe në ish-R.J. të Maqedonisë shpjegohen kryesisht me angazhimin e forcave të caktuara në Serbi e gjetkë, për të penguar proceset demokratike në Kosovë dhe për të hedhur sërish rajonin në luftë. Kjo duhet të tërheqë vëmendjen e strukturave ndërkombëtare.

Perspektivat që trupat serbe të hyjnë në zonën asnjëse në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk e pakëson, por rrit rrezikun e konflikteve. Strukturave ushtarake serbe, të akuzuara për gjenocid dhe ende të indoktrinuara, s'mund t'u besohet roli i paqeruajtësve.

Duke parë rrezikun serioz të zhvillimeve të tilla, Kuvendi u bën thirrje shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni të tregojnë maksimumin e vëmendjes dhe të mënjanojnë energjikisht çdo shfaqje të dhunës dhe ekstremizmit, si dhe përshëndet me këtë rast deklaratimet, në këtë kuadër, të forcave politike shqiptare në Kosovë e Maqedoni.